




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr. 28, datë 05.10.2023

PËR



MIRATIMIN E KORRIGJIMIT TË KOORDINATAVE TË LEJES NR.642 PROT., DATË 05.07.2023 DHËNË ME VENDIMIN NR.23 DATË 29.06.2023 SË PËRDORIMIT TË BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK, NGA KBU SEMAN, SUBJEKTIT "IDI 2005"SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e korrigjimit të koordinatave të lejes nr.642 prot., datë 05.07.2023 dhenë me vendimin nr.23 datë 29.06.2023 së përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik, nga KBU Seman, subjektit "Idi 2005" sh.p.k, me vendndodhje në përroin e Kamiçanit dhe Bistës, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Kamiçan

Vepra e marrjes 1

- X = 525171; Y = 4538404; Z = 820m.m.n.d.(KRGJSH)



- Prurjamesatare $Q_{mes} - 0.437 m^3/s$
- Prurjallogaritëse $Q_{llog} - 0.55 m^3/s$
- Prurjaekologjike $Q_{eko} - 0.06 m^3/s$
- Sasia e ujit që jepet në përdorim $Q - 0.55 m^3/s$

Vepra e marrjes 2

- $X = 524851$; $Y = 4538680$; $Z = 820$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurjamesatare $Q_{mes} - 0.104 m^3/s$
- Prurjallogaritëse $Q_{llog} - 0.15 m^3/s$
- Prurjaekologjike $Q_{eko} - 0.04 m^3/s$
- Sasia e ujit që jepet në përdorim $Q - 0.15 m^3/s$

Godinae Centralit

- $X = 522920$; $Y = 4533781$; $Z = 488.5$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Vëllimi i rrjedhës së kthyer: $0.7 m^3/s$

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ky vendim hyn në fuqi mbas konfirmimit të instalimit të stacionit hidrologjik tek vepra e marrjes dhe të stacionit metrologjik pranë godinës së centralit
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBUSEMAN

